

LIGJ
Nr.9688, datë 5.3.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT TEKNIK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË JAPONISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e bashkëpunimit teknik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5220, datë 13.3.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK NDËRMJET QEVERISË SË JAPONISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Qeveria e Japonisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë,
duke dëshiruar forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore, që ekzistojnë midis dy vendeve, nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit teknik;
duke pasur parasysh përfitimet reciproke nga zhvillimi ekonomik dhe social i të dy vendeve respektive;
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Të dyja qeveritë duhet të përpiqen për të nxitur bashkëpunimin teknik ndërmjet dy shteteve.

Neni 2

Marrëveshje të veçanta, të cilat lidhen me programet specifike të bashkëpunimit teknik, që do të zbatohen nga kjo Marrëveshje, duhet të miratohen paraprakisht nga autoritetet kompetente të të dyja qeverive.

Autoriteti kompetent i Qeverisë së Japonisë është Ministria e Punëve të Jashtme dhe autoriteti kompetent i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë është Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Format e mëposhtme të bashkëpunimit teknik do të kryhen nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (këtu e tutje referuar si JICA), me shpenzimet e veta, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në Japoni, si dhe rregullimet në bazë të nenit 2:

- a) Sigurimin e trajnimeve teknike për shtetasit shqiptarë;
- b) Dërgimin e ekspertëve (këtu e tutje referuar si “Ekspertë”) në Republikën e Shqipërisë;
- c) Dërgimin e vullnetarëve japonezë, me njohuri të gjera teknike dhe me përvojë të konsiderueshme (këtu e tutje referuar si “Vullnetarë të nivelit të lartë”) në Republikën e Shqipërisë;
- d) Dërgimin e misioneve japoneze (këtu e tutje të referuara si “Misione”) në Republikën e Shqipërisë, të cilat do të kryejnë vëzhgime për projektet, e zhvillimit ekonomik dhe social, në Republikën e Shqipërisë;
- e) Pajisjen e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me pajisje, makineri dhe materiale; dhe
- f) Sigurimin e formave të tjera të bashkëpunimit teknik për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të cilat mund të vendosen me pëlqim reciprok ndërmjet të dyja qeverive.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të sigurojë që njohuritë dhe teknikat e përfituara nga shtetasit shqiptarë, si dhe pajisjet, makineritë dhe materialet e dërguara si rezultat i bashkëpunimit ekonomik japonez, sikurse parashikohet edhe në nenin 3, t’i shërbejnë zhvillimit ekonomik dhe social të Republikës së Shqipërisë dhe se nuk do të përdoren për qëllime ushtarake.

Neni 5

Në rastet kur JICA dërgon ekspertët, vullnetarët e nivelit të lartë dhe misionet, Qeveria e Republikës së Shqipërisë:

1.a) duhet të përjashtojë ekspertët, vullnetarët e nivelit të lartë dhe anëtarët e misioneve nga taksat, duke përfshirë këtu edhe taksat e të ardhurave, si dhe çdo detyrim tjetër fiskal që ka të bëjë me pagat apo çdo të ardhur, apo ndihmë financiare që ata marrin nga jashtë;

b) duhet të përjashtojë ekspertët, vullnetarët e nivelit të lartë dhe anëtarët e misioneve dhe familjet e tyre nga çdo tarifë konsullore, taksë apo detyrim doganor dhe detyrimet fiskale, si dhe nga kërkesat për pajisjen me licencë importi dhe certifikatë të shkëmbimeve me jashtë, përsa i përket importit:

- i) të bagazheve;
- ii) të sendeve personale, pajisjeve shtëpiake dhe mallrave të konsumit;
- iii) të një mjeti udhëtimi për çdo ekspert, për familjen e ekspertit, për secilin vullnetar të nivelit të lartë dhe për familjen e tij, të cilët janë të caktuar për të qëndruar në Republikën e Shqipërisë;
- c) të përjashtojë ekspertët, vullnetarët e nivelit të lartë, si dhe familjet e tyre që nuk importojnë ndonjë mjet udhëtimi në Republikën e Shqipërisë nga taksat që përfshijnë TVSH-në, si dhe detyrime fiskale në lidhje me blerjen e një mjeti udhëtimi për çdo ekspert, për familjen e ekspertit, të vullnetarit të nivelit të lartë dhe për familjen e tij;
- d) si dhe të përjashtojë ekspertët, vullnetarët e nivelit të lartë, si dhe familjet e tyre nga taksa e regjistrimit të mjetit të sipërpërmendur (b) iii dhe c;

2.a) Të sigurojë me shpenzimet e saj, zyra të përshtatshme dhe lehtësira të tjera, duke përfshirë telefon, faks, të nevojshme për kryerjen e detyrave të ekspertëve, vullnetarëve të nivelit të lartë dhe misioneve, si dhe shpenzimeve për ruajtjen apo mirëmbajtjen e tyre;

b) të sigurojë me shpenzimet e veta për stafin lokal (duke përfshirë përkthyesit, nëse është e nevojshme), si dhe homologët shqiptarë të ekspertëve, vullnetarëve dhe misioneve për kryerjen e detyrave të tyre;

- c) merr përsipër shpenzimet e ekspertëve dhe vullnetarëve të nivelit të lartë:
 - i) për transportin e përditshëm për/dhe nga puna;
 - ii) udhëtimet e tyre zyrtare në Republikën e Shqipërisë;
 - iii) si dhe korrespondencën e tyre zyrtare;
- d) të sigurojë lehtësira për akomodimin e përshtatshëm të ekspertëve, vullnetarëve të nivelit të lartë dhe familjeve të tyre;
- e) si dhe të sigurojë lehtësira për kujdesin shëndetësor dhe mjetet për ekspertët, vullnetarët e

nivelit të lartë, anëtarët e misionëve dhe familjet e tyre.

3.a) Të lejojë ekspertët, vullnetarët e nivelit të lartë dhe anëtarët e misionit, si dhe të familjeve të tyre të hyjnë, dalin dhe qëndrojnë lirisht në Republikën e Shqipërisë, për sa kohë që ata janë me detyrë atje, si dhe t'u ofrojë lehtësira në procedurat e regjistrimit të të huajve, si dhe t'i përjashtojë ata nga taksat konsullore;

b) të pajisen ekspertët, vullnetarët e nivelit të lartë dhe anëtarët e misionit me karta identiteti që të sigurojnë bashkëpunimin e tyre me institucionet qeveritare, për të mundur kryerjen e detyrës së tyre;

c) t'u krijojë të gjithë ekspertëve, vullnetarëve të nivelit të lartë, si dhe familjeve të tyre mundësinë për marrjen e patentës për të udhëtuar; dhe

d) të marrë të gjitha masat e nevojshme për përmbushjen e detyrave të ekspertëve, vullnetarëve të nivelit të lartë dhe misionëve.

2. Mjetet e udhëtimit të përmendura në paragrafin 1 do t'u nënshtrohen çdo lloj takse apo detyrimi doganor, nëse ato shiten apo transferohen në Republikën e Shqipërisë te persona apo organizata, të cilët nuk janë të përjashtuar nga këto detyrime apo përfitime të ngjashme.

3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet t'u mundësojë ekspertëve, vullnetarëve të nivelit të lartë dhe anëtarëve të misionit dhe familjeve të tyre këto privilegje, përjashtime dhe përfitime, të cilat nuk janë më pak të favorshme se ato që u jepen ekspertëve, vullnetarëve të nivelit të lartë, anëtarëve të misionit dhe familjeve të tyre, të ndonjë vendi të tretë ose të ndonjë organizate ndërkombëtare të ngjashme me mision të ngjashëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6

Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk do të ngrejë pretendime, nëse ato lindin, ndaj asnjë eksperti, vullnetari të nivelit të lartë apo anëtarëve të misionit, gjatë ose në lidhje me ushtrimin e detyrave të tyre, përveç rastit kur të dyja qeveritë bien dakord që këto pretendime vijnë si shkak i neglizhencës së rëndë ose shkeljeve të qëllimshme nga ekspertët, vullnetarët e nivelit të lartë ose anëtarët e misionëve.

Neni 7

1. 1) Nëse JICA furnizon Qeverinë e Republikës së Shqipërisë me pajisje, makineri apo materiale, Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet t'i përjashtojë këto pajisje nga të gjitha llojet e taksave dhe detyrimeve fiskale, si edhe nga kërkesat për pajisjen me licencë importi dhe certifikatë për shkëmbime të mallrave të huaja. Pajisjet, makineritë dhe materialet e mësipërme do të bëhen pronë e Qeverisë së Shqipërisë në momentin që ato zbarkojnë në vend.

2) Nëse JICA furnizon Qeverinë e Republikës së Shqipërisë me pajisjet, makineritë dhe materialet, Qeveria duhet t'i përjashtojë pajisjet, makineritë dhe materialet nga taksat që përfshijnë TVSH-në, si edhe nga të gjitha detyrimet e tjera fiskale, në përputhje me çmimet në vend.

3) Pajisjet, makineritë dhe materialet e lartpërmendura në paragrafin 1 dhe 2 duhet që të përdoren vetëm për qëllimet e specifikuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje ose në të kundërt duhet të bien dakord autoritetet kompetente të qeverive.

4) Shpenzimet për transportin e këtyre pajisjeve të përmendura në paragrafin 1 dhe 2, si dhe ato për mirëmbajtjen apo riparimin e tyre duhet të mbulohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

2. 1) Të gjitha pajisjet, makineritë dhe materialet e përgatitura nga JICA, që shërbejnë për kryerjen e detyrave të ekspertëve, vullnetarëve të nivelit të lartë apo misionëve mbeten pronë e JICA-së, derisa të ketë marrëveshje midis autoriteteve kompetente të të dyja qeverive.

2) Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet t'i përjashtojë ekspertët, vullnetarët e nivelit të lartë dhe misionet nga çdo taksë konsullore, doganore apo fiskale, si dhe nga kërkesa për pajisjen me licencë të shkëmbimeve të mallrave të huaja, në lidhje me importimin e materialeve dhe pajisjeve të përmendura në paragrafin e mësipërm 1.

3) Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të përjashtojë ekspertët, vullnetarët e nivelit të lartë dhe anëtarët e misionëve nga taksat, që përfshijnë TVSH-në, si edhe nga të gjitha detyrimet e tjera fiskale, në përputhje me çmimet në vend të pajisjeve, makinerive dhe materialeve të përmendura në paragrafin 1.

Neni 8

Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të mbajë kontakt të ngushtë, nëpërmjet përfaqësive/organizatave përkatëse, me ekspertët, misionarët apo vullnetarët.

Neni 9

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të pranojë që JICA të ketë një zyrë përfaqësie të saj në Shqipëri (referuar më poshtë si “Zyra”) dhe duhet të pranojë një përfaqësues të JICA-së me stafin e tij apo të saj, të sjellë nga Japonia (referuar më poshtë si “Përfaqësuesi” dhe “Stafi”), të cilët duhet të kryejnë detyrat e caktuara nga JICA, përsa i përket programit të bashkëpunimit teknik në bazë të kësaj Marrëveshjeje në Shqipëri.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet:

1.a) Të përjashtojë përfaqësuesin, stafin dhe familjet e tyre nga çdo taksë të ardhurash apo detyrimi fiskal të vendosur në lidhje me pagën apo shpenzimet e tyre ditore të ardhura nga jashtë;

b) Të përjashtojë përfaqësuesin, stafin dhe familjet e tyre nga taksat konsullore, doganore dhe çdo detyrim fiskal, si dhe nga kërkesa për pajisje me licencë apo certifikatë për shkëmbime me jashtë në lidhje me importimin e artikujve të mëposhtëm:

i) bagazheve;

ii) sende personale, artikuj shtëpiakë dhe mallra konsumi;

iii) një mjet udhëtimi për përfaqësuesin, stafin për familjet e tyre, si dhe për atë pjesë të stafit që do të qëndrojnë në Shqipëri;

c) Të përjashtojë përfaqësuesin, stafin dhe familjet e tyre, të cilët nuk importojnë mjet udhëtimi në Shqipëri nga taksat që përfshijnë TVSH-në dhe detyrimet fiskale, lidhur me çmimin në vend të një mjeti udhëtimi për përfaqësuesin, stafin, familjen e tyre, nëse ato do të blejnë në Shqipëri mjetin e udhëtimit;

d) Të përjashtojë përfaqësuesin, stafin dhe familjet e tyre nga taksa e regjistrimit të mjeteve të udhëtimit në a dhe b;

e) Të lejojë përfaqësuesin, stafin dhe familjet e tyre të hyjnë, dalin dhe qëndrojnë në Shqipëri, për sa kohë që janë të akredituar këtu, si dhe t’u ofrojnë atyre të gjitha lehtësirat për t’u regjistruar si të huaj dhe të përjashtohen nga taksat konsullore;

f) Të pajisë me karta identiteti dhe karta të tjera të posaçme për qarkullim për përfaqësuesin ,si dhe për stafin për hyrje në aeroporte, porte detare jashtë kontrollit të zakonshëm të pasaportave në pikat e kontrollit, në pritjen dhe përcjelljen e ekspertëve, vullnetarëve të nivelit të lartë dhe anëtarëve të misionit;

g) T’i ofrojë përfaqësuesit, stafit dhe familjeve të tyre lehtësira për përfitimin e patentës së makinës; dhe

h) Të marrë masa të tjera të nevojshme për kryerjen e detyrave të përfaqësuesit dhe stafit të tij.

2.a) Të përjashtojë zyrën e përfaqësisë nga detyrimet konsullore, taksa ku përfshihen dogana dhe detyrime të tjera fiskale, si dhe nga kërkesa për licencë importi në rastet e importimit të pajisjeve, materialeve të nevojshme për veprimtarinë e zyrës;

b) Të përjashtojë zyrën nga çdo taksë që përfshin TVSH-në dhe detyrime fiskale, lidhur me çmimin në vend të pajisjeve, makinerive, mjeteve të udhëtimit dhe materialeve të nevojshme, për kryerjen e funksioneve të zyrës;

c) Si dhe të përjashtojë zyrën nga çdo taksë ndaj të ardhurave apo shpenzimeve të zyrës, që vijnë nga jashtë.

3. Mjetet motorike të përmendura në paragrafin 2 do të jenë subjekte të tatueshme, nëse janë shitur apo transferuar në Shqipëri te persona të tretë ose organizata, që nuk janë të përjashtuara nga taksa apo privilegje të njëjta.

4. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t’i akordojë përfaqësuesit, stafit dhe familjeve të tyre, si dhe zyrës ato privilegje, përjashtime apo lehtësira që gëzojnë përfaqësuesit, stafi dhe familjet e tyre, si zyra, organizata apo përfaqësi të tjera që veprojnë në vend dhe kryejnë mision të ngjashëm.

Neni 10

Qeveria duhet të marrë masat e nevojshme për sigurinë e ekspertëve, vullnetarëve dhe anëtarëve të misionit, përfaqësuesit, stafit dhe familjeve të tyre gjatë qëndrimit në Shqipëri.

Neni 11

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Japonisë duhet të konsultohen në rast të ndonjë problemi që lind gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje duhet të jenë të zbatueshme pas hyrjes në fuqi të saj, ndaj programit të bashkëpunimit teknik, i cili ka nisur para se të hyjë në fuqi kjo Marrëveshje, si dhe ndaj ekspertëve, vullnetarëve të nivelit të lartë, anëtarëve të misionit, përfaqësuesit, stafit dhe familjeve të tyre që qëndrojnë në Shqipëri, si dhe të të gjitha materialeve dhe pajisjeve që lidhen me zbatimin e këtyre programeve.

2. Afati i përfundimit të kësaj Marrëveshjeje nuk duhet të cenojë programin e bashkëpunimit teknik dhe realizimin e tij, deri në datën e përmbyshjes së programit, vetëm në ato raste kur bien dakord të dyja qeveritë respektive, si dhe ndaj përfitimeve dhe privilegjeve të dhëna ekspertëve, vullnetarëve të nivelit të lartë, anëtarëve të misioneve, përfaqësuesit, stafit dhe familjeve të tyre në Shqipëri për kryerjen e detyrave të tyre të lidhura me programet.

Neni 13

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit me shkrim të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë nga Qeveria e Japonisë, për plotësimin e kërkesave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një vit dhe duhet të rinovohet automatikisht çdo një vit, deri kur njëra nga qeveritë respektive të dërgojë një njoftim paraprak me shkrim, gjashtë muaj para, për mbarimin e kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në ...më ...2006 në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.